REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE

Nr.1586.prot. Gramsh, më 15/04/2024

SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NË DETYRË NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË E MESME DREJTUES (DREJTOR DREJTORIE)

Lloji i diplomës: *"SHKENCAT EKONOMIKE"*

Niveli minimal i diplomës: *"MASTER SHKENCOR"*

Në bazë të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", Kreu V "lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë" neni 25 dhe 26; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242, datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese" Kreu II dhe Kreu III; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.142, datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në Institutcionet e Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Pavarura (ndryshuar VKM nr.305, datë 05.04.2017); Vendmit nr.09, datë 28.02.2024 "Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në Shërbimin Civil, për vitin 2024" të Kryetarit; Urdhërit nr.121, datë 15.04.2024 "Për shpallje vendesh të lira pune në administratën e Bashkisë Gramsh" të kryetarit të bashkisë, Njësia e Burimeve Njerëzore, shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjen në detyrë, në shërbimin civil, në kategorinë e mesme drejtuese, për pozicionin:

Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, kategoria II, klasa II-b;

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët drejtuese

PËR TË DYJA PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE:	**25.04.2024**
Afati për dorëzimin e dokumentave për NGRITJE NË DETYRË:	**30.04.2024**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:

1. ***Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit:***

Përgatit relacionin dhe projekt vendimin për buxhetin vjetor të bashkisë, për buxhetin afat-mesëm të bashkisë dhe për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve vjetore. Harton bilancin vjetor përmbledhës të bashkisë dhe njësive në vartësi. Ndjek në mënyrë periodike celjen e fondeve sipas zërave, merr pjesë në hartimin dhe shqyrtimin e huasë dhe del me propozime për miratim në këshillin e bashkisë. merr pjesë në hartimin e buxhetit vjetor, organizon alokimin e burimeve, kryen rishpërndarjen e të ardhurave dhe shpenzimeve, propozon parshikime për një menaxhim optimal të buxhetit për personelin, raporton për rezultatet e ekzekutimit të buxhetit të eprori direkt dhe koordinon punën me Ministrinë e Financave.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedure vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori (nivel i mesëm drejtues), në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

1. Të jetë nëpunës i konfirmuar, brenda të njëjtës kategori (drejtor) për të cilën aplikon, në cdo institucion të shërbimit civil;
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
3. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë";
4. Të plotësojë kriteret e vecanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit MASTER SHKENCOR -në shkencat EKONOMIKE;
2. Të ketë të paktën 5 (pesë) vite pune në profesion;
3. Njohja e një gjuhe të vendeve të BE-së përbën avantazh;

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vacant;

2. Jetëshkrim (CV) i plotësuar detyrimisht me të dhënat si adresë e-mail dhe adresën e saktë të vendbanimit;
3. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) shoqëruar me listën e notave (e noterizuar). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
4. Dëshminë e statusit të nëpunësit civil;
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
9. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
10. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
11. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Zyrës së Protokoll-Arkivit në Bashkinë Gramsh, brenda dates 25.04.2024

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën ***30.04.2024***, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Nerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në stendën e njoftimeve në ambientet e jashtme të Bashkisë, në portalin "AKPA" dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit bashkiagramsh.gov.al , **listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele** dhe kërkesat e posaçme, si dhe **datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet-intervista.** Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkaqet e moskualifikimit *(nëpërmjet adresës së e-mail).* Kandidatët të cilët rezultojnë të pakualifikuar kanë të drejtë të paraqesin ankesat me shkrim pranë njësisë së Burimeve Njerëzore, brenda 3(tre) ditëve nga data e njoftimit individual.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr.139/2015, date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore"
- Ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil"(i azhornuar);
- Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Kodin e Proçedurave Administrative;
- Ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit"

- Ligjin 9367,date 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit interesit(i ndryshuar);
-Ligji nr.138/2015, date 17.12.2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojne funksione publike";
- Rregulloren e Brendshme të Bashkise ;
-Legjislacionin e Shërbimit Civil;
-Kodi i Procedurës Administrative;
Legjislacioni mbi financat publike dhe zbatimin e buxhetit, kontabilitetit publik dhe legjislacionit të tatimeve;
-si dhe pyetje të tjera nga specialiteti perkates;

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën (20 pikë), trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën (10 pikë), si dhe çertifikimin pozitiv (10 pikë). Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në 22.05.2024

2 NGRITJA NË DETYRË NË KATEGORINË E MESME DREJTUESE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët drejtuese. Këtë informacion do ta merrni në faqen e të Bashkisë Gramsh, Portalin Kombëtar të Punësimit dhe stendën e Njoftimeve në ambientet e jashtme të Bashkisë, duke filluar nga data 30.04.2024

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedure kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që janë nëpunës civil të konfirmuar në nivelin e ulët drejtues, që plotësojnë kërkesat e veçanta për vendin e lirë nëpërmjet ngritjes në detyrë;

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë si vijon:

5. Të jetë nëpunës i konfirmuar, brenda të një kategorie paraardhëse (niveli i ulët drejtues, përgjegjës) në cdo institucion të shërbimit civil;
6. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
7. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë";
8. Të plotësojë kriteret e vecanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

4. Të zotërojnë diplomë të nivelit MASTER SHKENCOR -në shkencat EKONOMIKE;
5. Të ketë të paktën 5 (pesë) vite pune në profesion;
6. Njohja e një gjuhe të vendeve të BE-së përbën avantazh;

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vacant;
2. Jetëshkrim (CV) i plotësuar detyrimisht me të dhënat si adresë e-mail dhe adresën e saktë të vendbanimit;
3. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) shoqëruar me listën e notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
4. Dëshminë e statusit të nëpunësit civil;
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Zyrës së Protokoll-Arkivit në Bashkinë Gramsh, brenda dates 30.04.2024

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën ***03.05.2024***, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Nerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në stendën e njoftimeve në ambientet e jashtme të Bashkisë, në portalin "AKPA" dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit

bashkiagramsh.gov.al , **listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë në shërbimin civil** dhe kërkesat e posaçme, si dhe **datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.**

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet ngritjes në detyrë dhe kriteret e vecanta, do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkaqet e moskualifikimit *(nëpërmjet adresës së e-mail).* Kandidatët që nuk janë kualifikuar, Brenda 5(pesë) ditëve nga data e njoftimit individual, kanë të drejtë të paraqesin ankesat me shkrim pranë Njësisë së Burimeve Njerëzore.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr.139/2015, date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore"
- Ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil"(i azhornuar);
- Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Kodin e Proçedurave Administrative;
- Ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit"
- Ligjin 9367,date 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit interesit(i ndryshuar);
-Ligji nr.138/2015, date 17.12.2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojne funksione publike";
- Rregulloren e Brendshme të Bashkise ;
-Legjislacionin e Shërbimit Civil;
-Kodi i Procedurës Administrative;
Legjislacioni mbi financat publike dhe zbatimin e buxhetit, kontabilitetit publik dhe legjislacionit të tatimeve;
-si dhe pyetje të tjera nga specialiteti perkates;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
c- Motivimin, aspiratet dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratet dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "www.dap.gov.al" http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Lista e fituesve me mbi 70(shtatëdhjetë) pikë do të shpallet në datën 27.05.2024

Njoftimi do të bëhet në portalin "AKPA", në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

Afati për ankim është 5(pesë) ditë duke filluar nga data 22.05.2024.

Njësia përgjegjëse, në kushtet e rezultatit pa asnjë fitues ose me më pak fitues se planifikimi, rihap procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë në shërbimin civil, brenda 5(pesë) ditëve kalendarike nga përfundimi i shqyrtimit të akimeve.

K R Y E T A R I

BESION AJAZI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA GRAMSH